



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SIGURISË USHQIMORE DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr. 1051 Prot.

Tiranë, më 28.2. 2006

U D H Ë Z I M

Nr. 3 datë 28.2.06

P Ë R

ETIKETIMI I PRODUKTEVE USHQIMORE TË IMPORTUARA

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në zbatim të neneve 18 dhe 41 të ligjit nr.7941 datë 31.05.1995 "Për Ushqimin" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 7.11.2002 "Për një shtesë në Rregulloren "Për etiketimin e produkteve ushqimore", të miratuar me Vendimin nr.604 datë 17.11.2000, të Këshillit të Ministrave", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

U D H Ë Z O J:

1. Etiketimi i produkteve ushqimore të importuara, me përjashtim të atyre të përmendura në pikën 2 të këtij Udhëzimi, të bëhet në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.554 datë 7.11.2002 "Për një shtesë në Rregulloren "Për etiketimin e produkteve ushqimore", të miratuar me Vendimin nr.604 datë 17.11.2000, të Këshillit të Ministrave".
2. Etiketimi i produkteve ushqimore të paramballazhuara në thasë, bote, etj. të importuara, vaj, sheqer, oriz, miell dhe kafe, të cilat do të kalojnë në procesin e riamballazhimit përpara ofrimit tek konsumatori i fundit për konsum vetjak apo

kolektiv, të bëhet në përputhje me Rregulloren “Mbi etiketimin e produkteve ushqimore” miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.604 datë 17.11.2000.

3. Udhëzimi nr.2 datë 26.12.2002 “Mbi etiketimin e disa produkteve ushqimore të importuara” dhe Urdhëri nr.138 datë 18.3.2005 “Mbi mënyrën e etiketimit të produkteve ushqimore në hipermarkete” shfuqizohen.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij Urdhëri.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

A large, stylized handwritten signature in black ink, appearing to read 'Jemina Gjani', is written over the printed name.

JEMINA GJANA